



Prania / Dotezuar Prijeno / Prodato Received / Delivered	04.12.2023	3	viti god Year
Organ / Ujesta Orgao / Jedinstvo Org / Unit	Dr. Prof. Dr. Prof. Prof. No	Shirja e Prilog Appendix	Sasia Koliciteta Quantity
SKOVSHOK 7217/2023			119



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1300/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardit Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1300/2023 të datës 18.10.2023 të ankuesit \_\_\_\_\_, me adresë banimi: Rruga "Ali Hadri" Nr.49, Komuna e Gjilanit, kundër Njoftimit të datës 18.10.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.12.2023, mori këtë.

**V E N D I M**

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër me numër A.nr.1300/2023 e datës 18.10.2023, e parashtruar nga ankuesi .

**A r s y e t i m**

Ankuesi \_\_\_\_\_ me datë 18.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 18.10.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, lidhur me procedurën e zhvilluar për konkursin e shpallur për pozitën "Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale" në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, me pretendimin ankimor se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik duhet t'ia mundësoi ankuesit vazhdimin në fazat e tjera të rekrutimit pasi që për shkaqe të problemeve teknike me rastin e aplikimit nuk është ngarkuar Çertifikata e kërkuar e gjykatës përmes të cilës dëshmohet mos kryerja e veprës penale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 26.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese të KQZ, ndërsa me datë 30.10.2023, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankese se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosjen e kësaj lëndë, ka administruar këto prova: Vendimin e Këshillit A.nr.1136/2023 të datës 23.10.2023; Ankesën e datës 18.10.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 18.10.2023 me korrespondencën e bashkangjitur; Njoftimin e datës 18.10.2023; Njoftimin e datës 12.10.2023; kërkesën për përgjigje në ankese të datës 26.10.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 30.10.2023; Konkursin e datës 28.8.2023; Aplikacionin e ankuesit të datës 03.10.2023 me dokumentet e bashkangjitura; Njoftimin e listës së ngushtë të datës 12.10.2023.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit \_\_\_\_\_, është bërë i pamundur, *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se Ministria e Punëve të Brendshme përmes konkursit të datës 28.08.2023 ka shpallur konkursin publik për pozitën "Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale" në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa sipas aplikacionit të datës 03.10.2023 konstatohet se në këtë konkurs për pozitën e lartcekur ka aplikuar edhe kandidati \_\_\_\_\_, tani e tutje në cilësi të ankuesit.

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, në fazën e verifikimit të aplikacioneve, ankuesit ia kishte refuzuar aplikacionin me arsyetimin se i njëjti nuk kishte bashkangjitur siç kërkohej në konkurs edhe Çertifikatën e gjykatës përmes së cilës dëshmohej se kandidati nuk duhet të jetë i dënuar për vepër penale me vendim të formës së prerë, me ç'rast ankuesi ishte njoftuar me datë 12.10.2023. Tutje, ankuesi \_\_\_\_\_ i ishte drejtuar me e-mail Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me kërkesën që të pranojnë Çertifikatën në fjalë ngase për arsye teknike nuk e kishte bashkëngjitur me rastin e aplikimit me kërkesën që aplikacioni i tij rishqyrtohej dhe t'i mundësohej përfshirja në listën e ngushtë.

Përmes e-mailit me datë 18.12.2023 Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, aplikacionet apo plotësimi i aplikacioneve me dokumente shtesë pas kalimit të afatit për aplikim sikurse parashihet në konkurs nuk pranohen dhe aplikacionet e mangët refuzon, kurse po në të njëjtën datë më 18.10.2023 e kanë publikuar Njoftimin për listën e ngushtë sipas së cilës konstatohet fakti se ankuesi nuk është përfshirë në listën e ngushtë për pozitën "Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale".

Kolegji i Këshillit, nga administrimi shkresave të ankesave të tjera në procedurë shqyrtimi, ka gjetur ka gjetur se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/Ministria e Punëve të Brendshme, me datë 13.07.2023, kishte publikuar në sistem qendror elektronik (SIMBNJ), konkursin e hapur për pranim, me numër të referencës RN00012066, për pozitën e punës "Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale" e në të cilin konkurs



kishte aplikuar edhe ankuesi V.E i cili kishte parashtruar ankesë në Këshill me datë 01.09.2023 me pretendimin ankimor se anulimi i konkursit të datës 13.07.2023 për pozitën e punës "Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale" ishte bërë në mënyrë të kundërligjshme, me kërkesën që të anulohet konkursi i rishpallur me datë 28.08.2023 për të njëjtën pozitën "Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale" në kuadër të Ministrisë e Shëndetësisë.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të ankesës së ankuesit V.E kishte nxjerrë Vendimin me shifër A.nr.1136/2023 të datës 23.10.2023 përmes të cilit ka aprovuar ankesën e të njëjtit për shkak të konstatimit të shkeljeve ligjore dhe procedurale të ligjit material nga ana e Departamentit për Menaxhimin Zyrtarëve Publik/Ministrisë së Punëve të Brendshme, ashtu që në pikën II të dispozitivit të Vendimit të Këshillit A.nr.1136/2023 e kishte shfuqizuar Vendimin me Nr.1326/2023 të datës 28.08.2023 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve, duke e lënë në fuqi konkursin e anuluar i cili ishte shpallur me datë 13.07.2023 për pozitën "Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale", ndërsa e ka anuluar në tërsi konkursin e rishpallur të datës 28.08.2023 për të njëjtën pozitë, në të cilën rezulton të ketë aplikuar ankuesi . a dhe i cili ka hapur procedurë ankimore pranë Këshillit përmes ankesës së datës 18.10.2023 për shkak se i njëjti nuk ishte përfshirë në listën e ngushtë sipas konkursit të rishpallur me datë 28.08.2023

Prandaj nga se u tha si më lartë, pas rrethanave të krijuara juridike, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë" dhe mbi këtë bazë është konstatuar fakti së procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës së ankuesit Amir Keka të datës 18.10.2023 duhet të përfundojë, pasi që Këshilli përmes Vendimit të datës 23.10.2023 me shifër A.nr.1136/2023 ka vendosur për objektin e njëjtë të shqyrtimit dhe në rastin konkret është bërë i pamundur apo i kotë, gjegjësisht konkursi i rishpallur i datës 28.08.2023 për pozitën "Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale" në të cilën ka aplikuar ankuesi Amir Keka është anuluar në tërsi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.1300/2023

Flakron Gashi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit Ekzekutiv të Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale;
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.